



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.509/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Goran Milenković, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “DWH-Kosova” shpk, -Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizimi me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-5928-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Komuna e Gjakovës, më datë: 12.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “DWH-Kosova” shpk, -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-5928-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Komuna e Gjakovës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizimi me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-5928-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Komuna e Gjakovës, dhe nëse më tutje AK ka interes për vazhdim të këtij aktiviteti të prokurimit mund të vazhdojë sipas dispozitave të LLP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues:“DWH-Kosova”shpk-Prishtinë,aprovohet pjesërisht si e bazuar, të njëjtit i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimi për kontratë është bërë me dt:08.08.2019.

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është bërë me dt: 15.08.2019.

Operatori ekonomik ankues:“DWH-Kosova” shpk-Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 15.08.2019, me nr.509/19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizimi me instrument GPS” me nr. të prokurimit: 632-19-5928-1-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues– Komuna e Gjakovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 9 dhe 28, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së,me datën: 28.08.2019, ka autorizuar ekspertine jashtëm teknik dhe ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertii jashtëm teknik dhe eksperti shqyrtues, në raportin e dt: 30.08.2019,sqaron si në vijim:

Pretendimi 1: “AK ka shkelur nenin 1 7, 9 dhe 28 është bazuar ne produktin e një prodhuesi te caktuar - Sokkia - , dhe specifikirnet e tij i ka kthyer ne specifikime te tenderit duke e bere te qarte pa filluar tenderi, se kush do jete produkti (GCX3/SCH5000), prodhuesi (Sokkia) dhe OE fitues (GeoTech).Përgjigje: Bazuar ne dokumentacionin e kësaj lende konsideroj se specifikimi teknik nuk është ne përputhje me ligjin e LPP pasi nuk paracakton se cilat janë specifikat minimale teknike për këtë procedure.

Bazuar ne statusin e lendes duke marre për baze qe AK ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit duke u bazuar ne arsyetimin : “Komuna e Gjakovës ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit për Ri-shpallje “Furnizim me instrument

GPS” me Nr. të Prok 632-19-5928-1-3-6. Me dt.08.08.2019, kemi pasur kërkesë për rishqyrtim, për disa mospajtime që Operatorët ekonomik kanë pasur lidhur me kërkesat dhe kushtet e Autoritetit kontraktues në dosjen e tenderit. Po të njëjtën ditë – 08.08.2019, e kemi bërë pezullimin e lëndës dhe me dt.14.08.2019, e kemi ngarkuar edhe vendimin. Problemi qëndron se pezullimin e kemi ngarkuar në platformë te dosja e tenderit “Shto document të ri” e jo te Kërkesat për rishqyrtim dhe në këtë mënyrë na ka kaluar afati sepse sistemi nuk e ka bërë automatikisht pezullimin e aktivitetit. Në një situatë të tillë ne jemi të detyruar të bëjmë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.”

Andaj bazuar ne Specifikat teknike te kësaj Dosje te Tenderit dhe Vendimin e AK-se për Anulim te këtij Aktivitetit konsideroj se Ankesa duhet te pranohet si pjesërisht e Bazuar për faktin se Specifikat teknike nuk tregojnë specifikat minimale teknike dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se për anulim te këtij Aktiviteti dhe nëse AK sheh te arsyeshme te Shpall ri tender për këtë Aktivitet te përgatit Specifikat me kërkesat minimale te cilat duhet te plotësohen nga OE te ndryshëm.

Mendimi i ekspertit Shqyrtues/Teknik

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të pranohet si pjesërisht e bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se.

Operatori ekonomik, përmesparashtresës me shkrim të datës: 31.08.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues,përmes parashtresës me shkrim të datës: 03.09.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 12.09.2019, ku kanë qenë prezent kryetari i panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e OE-së znj. Gagica deklaroj: Ne bazë te ligjit kemi ankimuar si përgatitje si te një anshme te tenderit edhe refuzimin e Autoritetit Kontraktues ndaj kërkesës sonë për te rishqyrtuar specifikat teknike te përgatitura nga një OE te caktuar, ndërkohe Autoriteti Kontraktues e ka anuluar tenderin ndërsa seanca sotme nuk mbetet gjë tjetër vetëm te pranoj dhe te pranoj vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim te tenderit, ne ketë përfundim ka arrit ne përfundim edhe ekspertit shqyrtues dhe me te cilin ne kemi shprehur mendimin tone me shkrim. Persë me sipër dua ti bej trupit gjykues me dije me sa vijon: Autoriteti Kontraktues ka hapur një tender një vit me pare me specifika tjera dhe vendimet e saj janë refuzuar nga paneli ne mënyrë te vazhdueshme, por Autoriteti Kontraktues u mundua për një vit me radhë ta anashkaloj ligjin dhe vendimet e OSHP-së kur nuk ia doli mbanë e anuloi mbas një viti tenderin këtë vit e hapi tenderin bazuar ne një prodhues dhe një OE te caktuar si tenderin e vitit te kaluar por me dallime qe këtë radhe ishte bazuar ne një prodhues dhe ne një OE te ndryshëm nga ai i kaluar. Ne jemi te sigurt qe AK do te rihap përsëri tenderit dhe i bëjmë me dije panelit shqyrtues qe AK do të bëjë prapë blerjen e Instrumentit te caktuar. Qëndrojmë prapa pretendimeve tona ankimore.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Jusufi deklaroj: Ankesat kanë qen te numri i kanaleve te GPS dhe asnjë shifër nuk është fikse por vetëm minimale, ne e dimë qe kompania ankuese ka instrumente edhe me më shume kanle. Kërkesë tjetër ka qenë qe pse e kemi bre kërkesën me windos dhe jo me IOS apo android, Windowsi është marke e mire dhe kompania i ka këto sisteme por nuk donë me konkuruar. Këto kanë qenë ankesat e OE-se ankuese.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e OE-së znj. Gagica deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovoj ankesën tone si te bazuar.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së z. Jusufi deklaroj: Kërkojmë te hedhet poshtë ankesa e OE si e pa bazuar dhe te mbetet ne fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik konstaton se Operatori Ekonomik ankues pretendon se AK ka shkelur nenin 17, 9 dhe 28 është bazuar ne produktin e një prodhuesi te caktuar - Sokkia - , dhe specifikimet e tij i ka kthyer ne specifikime te tenderit duke e bere te qarte pa filluar tenderi, se kush do jete produkti (GCX3/SCH5000), prodhuesi (Sokkia) dhe OE fitues (GeoTech).

Bazuar ne dokumentacionin e kësaj lende Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik konstaton se specifikimi teknik nuk është ne përputhje me ligjin e LPP pasi nuk paracakton se cilat janë specifikat minimale teknike për këtë procedure.

Bazuar ne statusin e lendes duke marre për baze qe AK ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit duke u bazuar ne arsyetimin : “Komuna e Gjakovës ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit për Ri-shpallje “Furnizim me instrumentGPS” me Nr. të Prok 632-19-5928-1-3-6. Me dt.08.08.2019, kemi pasur kërkesë për rishqyrtim, për disa mospajtime që Operatorët ekonomik kanë pasur lidhur me kërkesat dhe kushtet e Autoritetit kontraktues në dosjen e tenderit. Po të njëjtën ditë – 08.08.2019, e kemi bërë pezullimin e lëndës dhe me dt.14.08.2019, e kemi ngarkuar edhe vendimin. Problemi qëndron se pezullimin e kemi ngarkuar në platformë te dosja e tenderit “Shto dokument të ri” e jo te Kërkesat për rishqyrtim dhe në këtë mënyrë na ka kaluar afati sepse sistemi nuk e ka bërë automatikisht pezullimin e aktivitetit. Në një situatë të tillë ne jemi të detyruar të bëjmë anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.”

Andaj bazuar ne Specifikat teknike te kësaj Dosje te Tenderit dhe Vendimin e AK-se për Anulim te këtij Aktivitetit Paneli shqyrtues edhe konform sqarimeve te ekspertit shqyrtues përkatësisht teknik konstaton se pretendimi ankimor është pjesërisht i Bazuar për faktin se Specifikat teknike nuk tregojnë specifikat minimale teknike dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se për anulim te këtij Aktiviteti dhe nëse AK sheh te arsyeshme te Shpall ri tender për këtë Aktivitet te përgatit Specifikat me kërkesat minimale te cilat duhet te plotësohen nga OE te ndryshëm.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -Komuna e Gjakovës

1x1 OE -DWH-Kosova shpk,-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim nëweb- faqe të OSHP-së.